

FINANCA

BULETINI MUJOR | NËNTOR 2024



MIRATOHET AKTI NORMATIV PËR KTHIMIN E KËSTEVE TË TATIM FITIMIT TË PARAPAGUAR NGA PROFESIONISTËT E LIRË

Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ për kthimin e kësteve të tatim fitimit të parapaguar nga profesionistët e lirë. Në komunikimin për mediat pas përfundimit të mbledhjes së qeverisë, Ministri i Financave informoi se nga ky akt normativ do të përfitojnë rreth 6450 tatimpagues, të cilët do të rimbursohen me një fond prej 501 milionë lekësh. Procesi i rimbursimit të fondeve do të

përfundojë brenda datës 31 dhjetor 2024 dhe për mbarëvajtjen e tij do të ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ministri Petrit Malaj theksoi faktin se qeveria shqiptare ka patur që në fillim vullnetin e plotë për të kthyer këto fonde te profesionistët e lirë, gjë që bëhet e mundur përmes miratimit të aktit normativ. Ndërkohë, akti parashikon edhe shuajtjen e detyrimeve eventuale që mund të kenë lindur gjatë kohës që ligji ishte në fuqi.

LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ, KONFERENCË TË PËRBASHKËT SHTYPI ME FMN DHE BSH NË MBYLLJE TË MISIONIT TË FMN

Ministri i Financave zhvilloi një konferencë të përbashkët për shtyp me shefen e Misionit të FMN-së dhe Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, në përfundim të diskutimeve 2 javore në kuadrin e Artikullit të Katërt të marrëveshjes së vendeve anëtare të FMN, mbi situatën makroekonomike dhe financiare të vendit. Në fjalën e tij, Ministri Malaj bëri

një prezantim të zhvillimeve kryesore ekonomike të vendit dhe perspektivës afat-mesme ekonomike të financave publike, ndërsa theksoi progresin thelbësor të arritur sa i përket konsolidimit fiskal dhe uljes së nivelit të borxhit publik. Nga ana e saj, shefja e misionit të FMN-së, vlerësoi se ekonomia shqiptare është kthyer në një ecuri të fortë, e mbështetur nga politika të kujdesshme makroekonomike dhe se politikat e kujdesshme fiskale kontribuuan në një reduktim të dukshëm të borxhit publik.

LEXO MË SHUMË



PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR 10-MUJORIN 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Tetor 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 10-mujore, arritën në rreth 589 miliardë lekë ose 99.8% e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mbledhën rreth 58 miliardë lekë më shumë ose 11% më shumë se 10 mujori i vitit 2023. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 10 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 517 miliardë lekë me një realizim në masën 91.7 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 7.1 përqind më i lartë ose rreth 33 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet korente, për periudhën 10 mujore të vitit 2024, rezultuan në rreth 462.9 miliardë lekë. Ky zë ka rezultuar 8.1 përqind më i lartë ose rreth 34.8 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

LEXO MË SHUMË

KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATOI NË PARIM PROJEKTBUXHETIN E SHTETIT PËR VITIN 2025



Kuvendi i Shqipërisë miratoi në parim projektbuxhetin e shtetit për vitin 2025, pas diskutimeve në seancën maratone në datat 18-19 Nëntor 2024. Në prezantimin e tij,

Ministri i Financave tha se projektbuxheti 2025 synon të mbështesë qytetarët shqiptarë dhe zhvillimin ekonomik të vendit, me një total prej 8.2 miliardë euro ose rreth dy herë më shumë se sa në vitin 2013. Ministri Malaj theksoi se projektbuxheti materializon plotësisht objektivat kryesore të politikës fiskale, përmes një balance primare pozitive; reduktimit të borxhit publik, duke targetuar për vitin 2025 uljen e borxhit në nivelin 55.8% të PBB; si dhe një raport të produktiv midis huamarrjes totale neto të buxhetit dhe shpenzimeve kapitale të qeverisë qendrore. Ministri tha se parashikohet që ekonomia të rritet me 3.9% vitin e ardhshëm.

LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ PREZANTON PROJEKTBUXHETIN 2025 NË KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR EKONOMINË DHE FINANCAVE



Ministri i Financave prezantoi për diskutim në parim projektbuxhetin e shtetit për vitin 2025, në komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Ministri Malaj theksoi faktin se projektbuxheti 2025

përmbush dy objektiva themelore, atë të sigurimit të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme, duke krijuar punësim, zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët shqiptarë, si dhe objektivin e konsolidimit fiskal, me qëllim final uljen e borxhit publik dhe ruajtjen e të gjitha parametrevë makroekonomikë e fiskal në nivele pozitive. Kështu, të ardhurat buxhetore për vitin 2025 parashikohen në masën 754.6 miliardë lekë ose 28.8% e PBB dhe krahasuar me planin e rishikuar për vitin 2024, me rreth 40.6 miliardë lekë më shumë. Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore janë parashikuar në nivelin 822.7 miliardë lekë me një rritje në vlerë absolute prej 51.4 miliardë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2024.

LEXO MË SHUMË



"PROJEKTBUXHETI 2025 MBËSHTET FINANCIMIN E SEKTORËVE PRIORITARË TË VENDIT"

Ministri i Financave prezantoi në komisionin parlamentar për Vepërimet e Prodhuesve, Tregtinë dhe Mjedisin projektligjin "Për buxhetin e vitit 2025". Ministri Malaj u shpreh se shpenzimet buxhetore për vitin e ardhshëm do të

përqendrohen në financimin e sektorëve prioritarë të vendit, si arsimit, shëndetësisë, infrastruktura, bujqësia dhe shërbimet dixhitale. Ministri theksoi se

projektbuxheti 2025 parashikon financimin e investimeve publike në masën 162 miliardë lekë ose 6.2% e Prodhimit të Brendshëm Bruto, duke mbështetur në vazhdimësi rritjen ekonomike, për të zhvilluar më tej turizmin, bujqësinë dhe infrastrukturën, si edhe duke nxitur punësimin. Po ashtu, paketa e investimeve mbështet axhendën e konektivitetit dhe infrastrukturën dixhitale, për t'i përgjigjur sa më mirë kërkesës në rritje të turizmit.

LEXO MË SHUMË

KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATON BUXHETIN FAKTIV TË VITIT 2023

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancë plenare projektligjin "Për buxhetin faktiv të vitit 2023", i cili fillimisht u paraqit para deputetëve nga Ministri i Financave, Petrit Malaj. Ministri Malaj tha buxheti i vitit 2023

pati si objektiv madhor reduktimin e efekteve që solli lufta në Ukrainë, përmes mbështetjes së shtresave në nevojë; mbështetjes së ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike dhe për sektorin e energjisë në tërësi, si dhe ruajtjen e rritjes së qëndrueshmërisë së ekonomisë dhe konsolidimit fiskal. Ministri theksoi se, përmes politikave fiskale të kujdesshme në drejtim të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, gjatë vitit 2023 u siguroi një ulje e qëndrueshme edhe e stokut të borxhit publik, angazhim që vijon të jetë prioritet i punës së Ministrisë së Financave.



LEXO MË SHUMË



"MENAXHIMI EFEKTIV I SHPENZIMEVE PUBLIKE, THELBËSOR PËR SIGURIMIN E STABILITETIT EKONOMIK DHE ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Ministri Petrit Malaj mori pjesë në takim mbi forcimin e mekanizmave dhe matjen e performancës së funksioneve të Thesarit, për menaxhimin e parasë së gatshme, të organizuar nga "PEMPAL Treasury Community of Practice (TCOP)". Gjatë takimit, me drejtuesit e lartë të TCOP-it dhe përfaqësuesit e BE, u theksua nevoja thelbësore për të forcuar sistemet e menaxhimit financiar publik dhe zbatimit të praktikave më të mira. Ministria e Financave ka ndërmarrë një sërë hapash në kuadër të forcimit të sistemeve të menaxhimit financiar, si: përmirësimi i Sistemeve të Planifikimit dhe

LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ NË KONFERENCËN MBI ROLIN E SISTEMIT BANKAR NË RRUGËN DREJT BE

Ministri Petrit Malaj mori pjesë në konferencën mbi rolin e sistemit bankar në rrugën drejt Bashkimit Evropian, ku theksoi rëndësinë e një bashkëpunimi institucional sa më të koordinuar dhe të standardizuar sa i përket proceseve të tregut. Në kuadër, Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, institucionet e kontrollit fiskal dhe

partnerët ndërkombëtarë. Fokusi ka qenë zhvillimi i kapaciteteve të përbashkëta për të forcuar monitorimin dhe raportimin e politikave financiare, në mënyrë që të sigurohet një qasje dhe standarde të njëjta, në përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga BE. Ministri Malaj tha se transformimi digjital është një nga fushat ku duhet të synohet nxitja e përdorimit të pagesave elektronike në mënyrë që të rritet akoma më shumë aksesin në financë i konsumatorëve shqiptarë, të reduktuhojë përdorimin e parasë "cash" dhe ekonomia të formalizohet më tej.

LEXO MË SHUMË